



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

C.nr. 2665/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen kontestimore të paditësit G.L nga fsh. V K-Pejës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. B.A nga Peja rr.”.....” S, kundër të paditurës KS-I Prishtinë sheshi ”.....” nr..., me objekt kontesti Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, jashtë seancës me dt. 09.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit G.L nga fsh. V , K.P, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. B.A nga Peja rr.”.....” S, kundër të paditurës KS-I në Prishtinë sheshi ”.....” nr..., me objekt kontesti Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kanë ushtruar padi me dt.22.11.2022, kundër të paditurës, me bazë juridike Kompensim Dëmi, vlera e kontestit 1,000 euro.

I autorizuari i paditësve me parashtresën e datës 23.01.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë ndaj të paditurës, për shkak se me të njëjtën kanë arritur ujdj jashtëgjyqësore.

Sipas dispozitës së nenit 261.1, LPK-së, e cila parashikon se paditësi mund ta tërheq padinë, pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin, në të cilën i padituri paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjersa paragrafi 2, parashikon se padia mund të tërhiqet edhe më vonë gjerë në përfundim të shqyrtimit kryesor, në çoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda afatit prej 7 dite, nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e nenit 261 par. 2, 3, dhe 4 e lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2665/22, dt. 09.02.2024**

**Gjyqtari
Besnik Shala**

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa,

Numri i lëndës: 2020:007254
Datë: 01.10.2021
Numri i dokumentit: 02235662

Konform nenit 261 pra.4 të LPK-së.